

Aneksi 3.3

UDHËZIME PËR APLIKANTËT SI TË PLOTËSONI ANEKSIN 3.2- PROJEKTI TEKNIK I PROPOZUAR - PJESA 2 DEKLARATA E TË ARDHURAVE

**Programi IPARD II
në kuadër të Instrumentit të Ndhmës së Para-Anëtarësimit të
Republikës së Shqipërisë
2014-2020**

**Versioni 1
2018**

Tabelat financiare përbëhen nga 2 faqe excel, përkatësisht:

1. Asetet e pranueshme
2. Deklarata e thjeshtuar e të ardhurave

I. Parimet e përgjithshme

- Për secilën nga faqet e Excel-it, mbushni vetëm qelizat e bardha në tabelë, ndërsa qelizat e theksuara / të ngjyrosura nuk duhet të "ndryshohen" pasi ato përmbajnë formula.
 - Deklarata e të ardhurave të projekt propozimeve teknike është një mjet për të provuar qëndrueshmërinë financiare të projektit dhe do të vlerësohet për pajtueshmërinë me të dhënat e ofruara në PROJEKTI TEKNIK I PROPOZUAR PJESA PERSHKRUESE , sipas përshkrimit të paraqitur, arsytive dhe shifrave. Pra, aplikanti duhet të sigurojë që të dyja pjesët janë të përafuara, kur paraqesin dosjen e aplikimit.
 - Ju lutem bëni kujdes, se TVSH nuk është subjekt i financimit, prandaj të gjitha shifrat për shitjet dhe kostot duhet të paraqiten me TVSH të përjashtuar.
 - Të gjitha fletët e mbushura duhet të përmbajnë emrin e aplikantit. Rekomandohet që aplikanti të mbushë emrin e tij në qelizat e ngjyrosura "D2" të tabelës 1 "Asetet e pranueshme", të cilat automatikisht do të transferohen në tabela të tjera të Planit të Biznesit.
- II. Shpjegime të detajuara.

1. Tabela 1: "Asetet e pranueshme"

Faqja "aseteve të pranueshme", përbëhet nga dy tabela. A: Tabela e kostove të pranueshme, e cila përbëhet nga të dhëna të detajuara për të gjitha ofertat e përzgjedhura të përzgjedhura nga aplikanti dhe B. Tabela 1.1: Madhësia e Grantit, e cila përcakton madhësinë e granteve të kërkuara.

Kolona A "Përshkrimi i asetit", duhet të jepet emri i secilit aset që i nënshtrohet financimit. Ju lutemi , shënoni në kolonën ku janë paraqitur pesë (5) seksione në varësi të llojit të investimit. Kjo ndarje është e rëndësishme që të respektohet, në mënyrë që të kryhet vlerësimi i duhur i dosjes, dhe shpjegimet e mëtejshme do të renditen më poshtë

Kolona B "Modeli, lloji / marka" duhet të përcaktohet modeli /marka dhe lloji (përfshirë modifikimin) e pajisjeve/ sistemeve që i nënshtrohen financimit. Për aktivitetet e ndërtimit / rindërtimit dhe krijimi i pemtoreve, është pranueshme të përcaktohet jo i aplikueshëm (n /a)

Kolona C "Specifikimet teknike bazë" duhet të sigurohen specifikimet bazë, siç janë kapaciteti, fuqia, dhe nëse nuk ka ndonjë madhësi

dhe peshë tjetër, është e rëndësishme që të paraqitet një karakteristikë, sipas së cilave krahasohen ofertat midis tyre .

Kolona D "Njësia" duhet të sigurohet që artikujt e ofruar të shprehen në njësi matëse, si copë, kg, ton, etj .Për Ndërtim /Pemtore / Investime në Sera, duhet të përcaktohet sipërfaqja në m2, ndërsa për shërbimet orët përkatëse, ose zonën e deklaruar në ofertën e përzgjedhur.

Kolona E "Sasia" duhet të sigurohet numri i aseteve të pranueshme, siç është përcaktuar në ofertën e përzgjedhur.

Kolona F "Çmimi në LEKE" duhet të pasqyrojë çmimin për njësi të aseteve, siç është përcaktuar në ofertën e përzgjedhur. Nëse oferta nuk është e shprehur në monedhën vendase (LEKE), ndiqni shënimin (*) ku poshtë tabelës duhet të përcaktohet monedha e ofertës , dhe krusi i këmbimit në lekë, sipas metodologjisë së publikuar në Udhëzimet për Aplikantët. Çmimi i nuk duhet të përmbajë TVSH ose taksa të tjera jo të pranueshme .

Kolona G "Vlera totale në LEKE" automatikisht do të llogarisë shumën totale të sejcilit aset në përputhje me sasinë dhe çmimet e paraqitura. Shuma totale e aseteve nuk përmban TVSH. Kjo kolonë nuk duhet t'i nënshtrohet modifikimit ose plotësimit nga aplikanti.

Kolona H "Vlera totale përfshirë TVSH-së" do të përfshijë sasinë totale përfshirë TVSH-në, në rast të furnitorëve vendas ose importit të jo të drejtpërdrejtë të pajisjeve. Në rast të importit të drejtpërdrejtë të mallrave dhe shërbimeve, aplikanti duhet të vendosë të njëjtën sasi siç është deklaruar në kolonën e mëparshme "G". Megjithatë të gjitha asetet në ofertat vendase (shqiptare) duhet të paraqiten me TVSH të përfshirë në kolonën H

Kolona I "Emri i furnitorit të përzgjedhur" duhet të pasqyrojë kompaninë që dorëzon ofertën e përzgjedhur, të deklaruar me emrin e plotë dhe formën ligjore.

Kolona I "numri i ofertës së përzgjedhur dhe data e lëshimit" duhet të pasqyrojë identifikimin e ofertës së zgjedhur.

Përveç kësaj, aktivitetet në vijim në kolonën A **"Përshkrimi i aseteve " duhet të plotësohet :**

Në seksionin "Pajisjet" duhet të renditet inventari i makinerive, që aplikanti ka përzgjedhur në të njëjtën mënyrë, sic janë paraqitur në ofertë.

Në seksionin "Ndërtim / Rikonstruksion / Pemtore dhe Serra:" duhet të shënohen të gjitha shpenzimet përkatëse, në të njëjtën mënyrë që ato janë paraqitur në ofertë. Për lehtësi, rekomandohet emërtimi i objektit në një qelizë të vetme ku mund t'i referohet sasive në preventiva .

Në seksionin "*Menaxhimi i shpenzimeve të mbetjeve/ rrjedhjeve*" është e rëndësishme që të renditen ato asete, që ofrohen në lidhje me shfrytëzimin e mbetjeve, veçanërisht në rastet kur kërkohet një përqindje më e lartë se granti.

Në seksionin "*Përgatitja e planit të biznesit*", duhet të paraqiten kostot e konsulencës për hartimin e Biznesi Planit aktual (nëse është e aplikueshme). Sigurohuni që jeni të njohur me kufijtë e kostove të konsulencës të përcaktuara në Udhëzimet për aplikantët për thirrjen përkatëse.

Në pjesën "*Kostot e përgjithshme*" duhet të paraqiten kostot e tjera paraprake, si përpunimi i projekteve të teknologjisë, dizenjimet arkitekturore etj. (Nëse aplikohet) Sigurohuni që të njiheni me kufijtë e kostove të konsulencës, të përcaktuara në Udhëzimet për aplikantët për thirrjen përkatëse

B. Tabela 1.1: Madhësia e Grantit

Kolona A " Granti Bazë" , duhet të përzgjidhet shkalla e intensitetit të projektit duke klikuar në qelizën "D35", ku aplikanti mund të përcaktojë përqindjen sipas:

- 60% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit;
- 65% e investimit të kryera nga fermerë të rinj;
- 70% e investimit që ndodhet në zonat malore;

Kolona B " Rritja e Grantit sipas normës në % për tu mbështetur" duhet të përzgjidhet, vetëm në rast të një aplikimi që përmban kosto për trajtimin e mbetjeve, të cilat mund të rrisin përqindjen themelore të Shtyllës A, me një madhësi shtesë prej 10%.

Kolona C dhe Totali i përqindjes së granteve dhe kolona D Granti në lekë do të llogaritet automatikisht dhe nuk duhet të ndërhyhet nga aplikanti.

Shembull : të plotësuar në " Asetet e pranueshme" paraqitet për sqarime në faqen tjetër:

3						-	-			
IV	Kosto e përgatitjes së Plan Biznesit									
4	Kosto konsulence	n/a	n/a	ditë	2,00	12 000,00	24 000,00	28 800,00	"Experienced Consultant" Sh.p.k, Albania	Cons13/01-05-2015
V	Kosto të Përgjithshme									
5						-	-			
Total Expenditures:							6 324 000,00 ALL	7 588 800,00 ALL		
*Ju lutem vendosni monedhen e ofertës së përzgjedhur	EUR	Ju lutem vendosni Kursi i Këmbimit të Monedhës table 1							140,32	

B. Table 1.1: Madhësia e Grantit

Madhësia e Grantit bazë	Rritja e Grantit sipas normës	Granti Total në	Grant në lekë
--------------------------------	--------------------------------------	------------------------	----------------------

		<i>në % për tu mbështetur</i>		<i>përqindje</i>			
A		B		C		D	
<p>Ju lutem zgjidhni madhësinë e grantit në % bashkëfinancimi në përputhje me masat e aplikuara</p> <p>:</p> <p>60% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit;</p> <p>65% e investimit të kryera nga fermerë të rinj;</p> <p>70% e investimit në zonat malore;</p>	65,00%	<p>Ju lutem përzgjidh në rast se aplikimi ka kosto për trajtimin e mbetjeve/rrjedhëve +10%;</p>	0,00%	<p>Totali i përqindjes për tu mbështetur</p>	65,00%	<p>Madhësia e Grantit në lekë</p>	<p>4 110 600,00 Lekë</p>

2. Tabela 2: Deklaratë e thjeshtuar e të Ardhurave

Tabela 2: Deklaratë e thjeshtuar e të Ardhurave përbëhet nga tabela e veçantë, qëllimi i të cilit është të tregojë qëndrueshmërinë ekonomike të investimit të propozuar. Aplikanti duhet të plotësojë **katër (4) shifra në kolonën B** "Viti i prodhimit normal" në të majtë në qeliza të bardha (qeliza të pa ngjyrosura) si më poshtë.

- Në qelizën "C6" duhet të plotësohet shifra e shitjes vjetore të projektit, e cila duhet të jetë në përputhje me përgjigjen e pyetjes # 9, nga pjesa e pyetësorit. Shuma duhet të paraqitet si të ardhura mesatare, nga viti i prodhimit normal, pa TVSH

I. Të ardhura	
1. Shitjet mesatare për vit (shumë totale)	(Të plotësohet në).....Lekë

- Në qelizën "C8" duhet të plotësohet kosto vjetore e shpenzimeve të projektit, e cila duhet të jetë në përputhje me përgjigjen e pyetjes # 10 nga pjesa e pyetësorit. Shuma duhet të paraqitet si kosto mesatare, nga viti i prodhimit normal, pa TVSH.

II. Kostot	
2. Kostot mesatare per vit (shumë totale)	(Të plotësohet në).....Lekë

Në qelizën "C9" duhet të plotësohet shifra vjetore e amortizimit të projektit, e cila duhet të jetë në përputhje me përgjigjen e pyetjes # 11 nga pjesa e pyetësorit.

3. Amortizimi (shumë totale) pajisje të projektit	(Të plotësohet në).....Lekë
---	-----------------------------

- Në qelizën "B12" Aplikanti duhet të përzgjedh në **kolonën A** (në të majtë në qelizat e pangjyrosura) në përputhje me përqindjen e taksimit sipas xhiros vjetore.

Për kompanitë:

- 0% për kompanitë me shkallë të vogël me qarkullim vjetor deri në 5 000 000 lekë;
- 5% për kompanitë me shkallë të mesme me qarkullim vjetor deri në 8 000 000 lekë;

- 15% për kompanitë në shkallë të gjerë me qarkullim vjetor mbi 8 000 001 lekë;

Për Individë

- 0% për të ardhurat personale deri në 30 000 lekë;
- 13% për të ardhurat personale nga 30 001 lekë në 130 000 lekë;
- 23% për të ardhura personale mbi 130 001 lekë;

IV. Tatimi (ju lutemi zgjidhni normën e tatimit, sipas shkallës së xhiros vjetore)	0,00%
---	--------------

Të gjitha qelizat e tjera nuk duhet të ndryshohen nga aplikanti dhe automatikisht do të tregojnë sa l qëndrueshëm është projekti.

TREGUESIT:

Për të pare qëndrueshmërinë e Projektit, si më poshtë:

- Fitimi neto

V. Fitimi Neto (III-IV)AL L
--------------------------------	--------------

Dhe

- Rrjedhja Neto e parasë për 5 vjet (vetëm në rastin e aplikimit për pajisje/) ose 10 vjet (në rast të punimeve të Ndërtimit /Rindërtim/Pemtore, Serat)

VIII. Rrjedhja Neto e parasë për 5 vjetë (V+4)*5)+(VII-VI)AL L
---	--------------

Duhet të jetë pozitive.

Modeli i plotësuar në tabelën 2 " **Deklaratë e thjeshtuar e të Ardhurave** " është treguar si më poshtë

Tabela 2: Deklaratë e thjeshtuar e të Ardhurave	
Për Individë	B
Treguesi i Kolonave	Prodhimi normal vjetor
A	B
I. Të Ardhurat	
1. Mesatare vjetore e shitjeve	3 000 000,00

(Shuma)	
II. Kostot	
2.Mesatare vjetore e kostove (Shuma)	1 000 000,00
3.Amortizimi (Shuma) pajisje të Projektit	1 260 000,00
Totali Kostove(2+3)	2 260 000,00
III. III. Fitimi (1-II)	740 000,00
IV. Taksa (Ju lutem përzgjidhni normën e taksimit sipas shkallës së xhiros vjetore)	170 200,00
	23%
V. Fitimi Neto (III-IV)	569 800,00
VI. IPARD Shpenzimet/kostot e pranueshme	6 324 000,00
VII. Financimi IPARD	4 110 600,00

Për investimet në pajisje	
VIII. Rrjedhja Neto e parasë për 5 vite $((V+4)*5)+(VII-VI)$	635 600,00
ose	
Për investimet për punime Ndërtim dhe rindërtim /sera dhe Pentore	
IX. IX.Rrjedhja Neto e parasë për 10 vite $>0 ((V+4)*10)+(VII-VI)$	3 484 600,00

Pas plotësimit, të dy tabelat duhet të printohen në kopje fizike , të nënshkruhem dhe të vulosen (vula nuk kërkohet për individë).